

V E N D I M
Nr.492, datë 21.10.1999

PËR FESTIMIN E 55-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8439, datë 29.12.1998 "Për buxhetin e shtetit të vitit 1999", me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në buxhetin e miratuar për vitin 1999 i shtohet fondi prej 9 000 0000 (nëntë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për festimin e 55-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1999.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko